



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 49/1 prot.

Tiranë, më 08.01.2024

VENDIM

Nr. 01, datë 08.01.2024

PËR KONTROLLUESIN “EUROCOM CX SH.P.K.”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Eurocom cx sh.p.k.” (në vijim, “Kontrolluesi ose Eurocom”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 199, datë 07.12.2023 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”), u krye hetim administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga subjekti i të dhënave B.C. në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi, është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS M21628019A dhe ushtron aktivitetin në fushën e komunikimit dhe telekomunikacionit, CRM, IT, për shërbimet e të dhënave për institucione publike dhe private. Gjatë ushtrimit të aktivitetit, kontrolluesi përpunon të dhëna personale për

kategoritë, “klient”, “punonjës”, “vizitor”, etj. Të dhënat personale përpunohen në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Pranë Zyrës së Komisionerit është paraqitur ankesa e subjektit të të dhënave B.C, nëpërmjet të cilës pretendon se, Kontrolluesi nëpërmjet kamerave të survejimit CCTV, kryen përpunim të të dhënave personale në kundërshtim me ligjin, pasi kamerat e survejimit mbikëqyrin ambientet e brendshme, përkatësisht zyrat dhe korridorin, ku në fokus janë punonjësit.

Nga verifikimet e kryera në vend, nga grupi i kontrollit rezulton se, Kontrolluesi ka të instaluar një sistem video survejimi, me anë të të cilit kryen monitorimin e ambienteve fizike gjatë ushtrimit të aktivitetit. Njësia qendrore e mbikëqyrjes së sistemit CCTV është vendosur në ambientet e Kontrolluesit. Sistemi i survejimit CCTV, është i përbërë nga 16 kamera, me anë të të cilave kryen mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme (zyrave dhe korridorit), në kundërshtim me parashikimet e neneve 5 dhe 6 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 11, datë 08.09.2011, të Komisionerit “*Mbi Përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat*”, i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimi nr. 11*”).

Njëkohësisht, është konstatuar se Kontrolluesi nuk informon subjektet mbi përpunimin e të dhënave imazhe-video, nëpërmjet sistemit të video-surveimit (CCTV), në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3, datë 05.03.2010 të Komisionerit “*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*”, i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimi nr. 3*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, një nga mjetet e rëndësishme të përpunimit të të dhënave personale është edhe sistemi i video/audio-surveimit (CCTV). Të dhënat e ruajtura në këto sisteme, si: “*imazhe*”, “*video*” dhe “*zëri/audio*”, janë të dhëna personale dhe përpunimi i tyre duhet të jetë në përputhje me parashikimet e Ligjit, si dhe aktet e miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesit.

Gjithashtu, informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të videosurvejimit (CCTV) është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit. Sipas Udhëzimit nr. 3, subjektet e të dhënave duhet të informohen qartësisht që një sistem video-survejimi është funksional dhe në veprim, duke vendosur në ambientet e survejuara modelin standard të tabelës informuese për mbikëqyrjen me sistemin e survejimit të miratuar nga Komisioneri.

3. Kontrolluesi ka të publikuar në faqen zyrtare <https://eurocomcx.com/> “*Politikat e Privatësisë*”, të cilat janë modele standarde (template) të politikave të privatësisë. Konstatohet se, Kontrolluesi nuk informon në gjuhën shqipe subjektet e të dhënave (klientë, vizitorë, punonjës, etj.), për fushën dhe qëllimin për të cilin do të përpunohen

të dhënat personale, për mënyrën e përpunimit, të drejtën për akses, të drejtën për fshirje dhe/ose korrigjim të të dhënave, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërbushja e këtij detyrimi, nga ana e Kontrolluesit, mund të sjellë pasoja të rënda, sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

4. Të dhënat sensitive (shëndetësore) të ish-punonjësve, të administruara nëpërmjet kartelës shëndetësore ruhen në ambientet e zyrës së burimeve njerëzore duke mos marrë, midis të tjerash, masa organizative dhe fizike për të garantuar sigurinë e të dhënave. Këto të dhëna sensitive përpunohen në kundërshtim me parimet dhe rregullat e parashikuara në Udhëzimin nr. 11.

Gjithashtu, nga analizimi i Rregullores së Brendshme dhe Kodit të Sjelljes, konstatohet se Kontrolluesi nuk ka parashikuar afate konkrete lidhur me kohën e ruajtjes së të dhënave personale dhe për dokumentacionin që administron në funksion të veprimtarisë që ushtron. Të dhënat e mbledhura nga Kontrolluesi ruhen pa përcaktuar një afat konkret të ruajtjes së tyre, në kundërshtim me germën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se Kontrolluesi është i detyruar të marrë masa sigurie (sipas nenit të 27 Ligjit) për mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve që përpunohen në fushën e marrëdhënies së punës, duke i kushtuar vëmendje të veçantë të dhënave sensitive. Të dhënat sensitive duhet të ruhen të ndara nga çdo e dhënë tjetër personale e punonjësve, duke vendosur rregulla të posaçme të dedikuara mbrojtjes së të dhënave sensitive të punonjësve.

Ndërsa, sa i takon kategorive të të dhënave të grumbulluara në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi duhet të parashikojë mbajtjen e të dhënave personale të grumbulluara, në atë formë që lejon identifikimin për një kohë të caktuar por, jo më tepër se sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin të dhënat janë grumbulluar, në përputhje me parashikimin e germës “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

5. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, si dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit rezultoi se Kontrolluesi nuk ka përmbushur detyrimin për “Njoftim” në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Kontrolluesi, pas marrjes dijeni të Urdhrit të hetimit administrativ, ka “Njoftuar” mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës. Megjithatë,

konstatohet se, “Njoftimi” ka mangësi në deklaram, sa i përket rubrikave të formularit, si vijon:

- Deklarimi në rubrikën nr. 2, Fusha e veprimtarisë: “*Shërbimin e marketingut*”;
- Deklarimi në rubrikën nr. 4, Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen: “*Tinguj*”;
- Deklarimi në rubrikën nr. 6. Qëllimi i përpunimit: “*Mbikëqyrje të ambienteve nëpërmjet kamerave Vëzhgim-Regjistrimi (CCTV)*”.

Konstatimet e mësipërme janë në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, detyrimi për “Njoftim” mbi përpunimin e të dhënave personale, sikurse edhe përditësimi i vazhdueshëm i gjendjes së përpunimit, sipas parashikimeve të neneve 21 dhe 22 të Ligjit është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre, nga ana e Kontrolluesit, si dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep Ligji.

6. Nga verifikimet e kryera gjatë hetimit administrativ rezulton se, Kontrolluesi nuk disponon “*Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”. Në datën 19.12.2023, Kontrolluesi ka dërguar nëpërmjet postës elektronike “*Rregullore për Mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*” e “*Eurocom CX*”, e cila nuk përmban elementët formalë për t’u konsideruar një akt i vlefshëm (*datë, nënshkrim, vulë, etj.*).

Megjithatë, nga shqyrtimi i përmbajtjes së saj konstatohet se, rregullorja nuk parashikon proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Kontrolluesit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, hartimi i një “*Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjektësh të të dhënave), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim mjaft i rëndësishëm, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, duke mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

7. Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete sa i përket trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit “*Për*

përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha” (në vijim, “Udhëzimi nr. 47”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, trajnimet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale duhet të jenë të vazhdueshme dhe të përshtatura sipas nevojave dhe proceseve të punës të Kontrolluesit. Për më tepër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, marrja e masave për zhvillimin dhe dokumentimin e trajnimeve të përshtatura për punonjësit, që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, është një nga masat e sigurisë së të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit në rrugë postare.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit me emalin e datës 27.12.2023, ka kërkuar shtyrjen e seancës dëgjimore për një datë tjetër. Zyra e Komisionerit ka marrë në konsideratë kërkesën e Kontrolluesit për shtyrjen e seancës dhe ka vendosur që shqyrtimi administrativ të zhvillohet në datën 03.01.2024, ku Kontrolluesi mund të marrë pjesë ose të delegojë pjesëmarrjen tek një përfaqësues me autorizim, si dhe të parashtrijë pretendime me shkrim, në lidhje me konstatimet e procesverbalit të hetimit administrativ.

Megjithatë, në datën e përcaktuar, Kontrolluesi nuk u paraqit në seancë dëgjimore dhe nuk parashtrijë pretendime me shkrim, lidhur me konstatimet e grupit të kontrollit të Zyrës së Komisionerit.

Në përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të germave “a”, “b”, “d” dhe “dh”, si dhe të pikës 1, të nenit 39 të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë si më poshtë:

- a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II “Përpunimi i të dhënave personale”, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;*
- b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;*
- d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;*
- dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë;*

Në bazë të pikës 2, të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara dhe pasojat janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave, me informimin dhe garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave, si dhe marrjen e masave të përshtatshme teknike dhe organizative për sigurinë e të dhënave personale.

PËR KËTO ARSYE:

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 18, 21, 22, 27, 29, 30, 39 pika 1, gjerat “a”, “b”, “d” dhe “dh”, si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

V E N D O S A:

- 1- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 200 000 (dyqind mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në Kreun II të Ligjit;
- 2- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 18 të Ligjit;
- 3- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 21 të Ligjit;
- 4- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenet 27 të Ligjit;
- 5- Kontrolluesi, të ketë në vëmendje përpunimin e të dhënave personale, për të gjitha proceset përpunuese, në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të sanksionuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit,
- 6- Kontrolluesi, të marrë masa për përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, për të gjitha proceset e përpunimit, në përputhje me germën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit;
- 7- Kontrolluesi të ndalojë monitorimin e punonjësve në vendin e punës përmes sistemit të survejimit CCTV, si dhe të shkatërrojë në mënyrë të parikuperueshme të dhënat “video/audio” të mbledhura për subjektet e të dhënave “punonjës”, të cilat janë përpunuar, në kundërshtim me dispozitat e neneve 5 dhe 6 të Ligjit. Në këtë kuadër, të mbajë evidenca për shkatërrimin;
- 8- Kontrolluesi, të marrë masa konkrete, për përmbushjen e detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale, në zbatim të detyrimeve të nenit 18 të Ligjit;

- 9- Kontrolluesi, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të ketë në vëmendje përditësimin e “Njoftimit”, në lidhje me ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave personale, të cilat përpunon;
- 10- Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të përfshijë në Rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, masa konkrete tekniko-organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj.;
- 11- Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, të ketë në vëmendje detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit, lidhur me trajnimin e vazhdueshëm të stafit të tij;
- 12- Në zbatim të pikës 1, të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti, brenda afateve, si vijon:
- i. menjëherë, detyrimet e përcaktuara në pikën 7 më sipër;
 - ii. vazhdimisht, detyrimet e përcaktuara në pikat 5, 8 dhe 9 më sipër;
 - iii. brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimin e treguar në pikat 6 dhe 10 më sipër;
 - iv. brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, detyrimet e treguara në pikën 11 më sipër.
- Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;
- 13- Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra;
- 14- Gjopa arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbartimit;
- 15- Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 08.1.2024.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi